



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:194174  
Datë: 27.10.2023  
Numri i dokumentit: 04841440

PPP.nr.848/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit “R...” me seli në Prishtinë, ndaj debitorit të përmbarimit S. K, lidhur me çështjen përmbarimore për pagesën e borxhit në shumën prej 26,178.07 euro, sipas detyrës zyrtare, jashtë seance, me datë 26.10.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.190/21, i datës 07.05.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat S. R nga Prishtina, si dhe të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi Privat S. R nga Prishtina me datë 07.05.2021, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.190/21, sipas propozimit të kreditorit “R...” me seli në Prishtinë, ndaj debitorit S. K nga Obiliqi, për pagesën e borxhit në shumë prej 26,178.07 euro, me kamatë ligjore deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke u bazuar në marrëveshjen për kredinë personale me numër 120462959, të datës 10.04.2019.

Kundër urdhrin të lartcekur të përmbaruesit privat ka paraqitur prapësim djali i debitorit G. K , përmes përfaqësueses sipas autorizimit A. S, i cili përveç tjerash në prapësim ka theksuar se babai i tij tashmë është i ndjerë dhe se ai ka ndërruar jetë me datë 23.10.2020.

Gjykata, me qëllim të verifikimit të këtij fakti, me datë 24.10.2023, i është drejtuar me kërkesë Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC), me të cilën ka kërkuar që të verifikohet nëse pala S. K nga Obiliqi ka ndërruar jetë. Me datë 25.10.2023, gjykata ka marrë përgjigjen nga ARC, ku

konstatohet se në Sistemin e Gjendjes Civile dhe në Librat Themeltar të Lindjes, qytetari S. K figuron i vdekur. ARC gjithashtu gjykatës i ka dërguar edhe kopjen e certifikatës së vdekjes me numër...

Nga Certifikata me numër serik..., e datës 28.10.2020, gjykata konstatoi se debitori S. K , ka ndërruar jetë më 23.10.2020. Gjykata, pasi që nga provat e përmendura si më lartë vërtetoi se debitori ka vdekur, erdhi në përfundim se urdhri për përmbarrim është i palejueshëm, sepse është lëshuar ndaj një personi i cili nuk mund të paraqitet si palë në procedurë, pasi që në kohën kur është lëshuar urdhri përmbarrimor, pra me datë 07.05.2021, debitori ka qenë i vdekur, sepse siç u vërtetua më lart debitori ka vdekur me datë 23.10.2020.

Gjykata vendosi kështu duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) ku është paraparë se “Palë - kreditori apo debitori në procedurën përmbarrimore”, ndërsa me nenin 17 të LPP-së parashihet se “Në procedurën përmbarrimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po që se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër”. Po ashtu neni 73, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka paraparë se “Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik”, ndërsa neni 76 i LPK-së parasheh se “Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm”.

Nga arsyet e lartcekura, gjykata vendosi që ta anulojë Urdhrin Përmbarrimor P.nr.190/2021, të datës 07.05.2021, si të palejueshëm, pasi që procedura nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundojë ndaj një personi i cili është i vdekur.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, vendosi duke u bazuar në nenin 13 të LPP-së, ashtu që vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës. Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATATHEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm  
PPP.nr.848/21, datë 26.10.2023

Gjyqtarja  
Qëndresa Beqiri Murati

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.